



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.102/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Glllogjani anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në vende publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 5,200.00 (pesëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e marrjes-pranimi të këtij vendimi, **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Paneli, me datën 06.06.2017, ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, në ora 16:20 kanë vërejtur se në rrethojat e parkut të qytetit në Dardanë është vendosur poster i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli nga koalicioni PDK-AAK-NISMA. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.11/2013, neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidaët dhe mbështetësit e tyre . Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës i ka prezantuar PZAP-it, një fotografi nga vendi ku është vendosur poster i që është objekt lëndor. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të aprovohet dhe ndërmarren veprimet ligjor ndaj shkelësit të kodit të mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatëve.

Në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017 koalicioni PDK-AAK-NISMA, ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se sipas pretendimeve ankimore shkelja nuk egziston, sepse në mungesë të hapsirave reklamuese Kuvendi Komunal i Kamenicës ka lejuar përdorimin e hapsirave dhe objekteve publike. Mëtej në përgjigje në ankesë theksohet se kjo dëshmohet me shkresën e Kuvendit Komunal e cila i bashkangjitet kësaj përgjegje në ankesën Anr.115/2017. Me propozim për PZAP-in, që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, te cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se posteri i kandidatit për deputet Kadri Veseli, nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, është vendosur në rrethojën e parkut të qytetit, e cila çështje është kundërshtuar në përgjigjen në ankesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se koalicioni i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike”*

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vndimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti se posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në hapsirë publike, gjegjësisht në rrethojën e parkut të qytetit, po ashtu e njëjta shkelje nga ky koalicion është përsëritur disa herë në këto zgjedhje.

Me rastin e vendosjes paneli mori parasysh edhe pretendimet e koalicionit të theksuar me lart, që theksohet se shkelja nuk ekziston sepse në mungesë të hapsirave reklamuese Kuvendi

